

UDHËZIM
Nr. 9, datë 16.3.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 13.4.2015, “PËR
KRITERET DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT DHE LIRIMIT NGA PUNA TË
DREJTUESVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE OFRUESE TË ARSIMIT DHE
FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 23, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 13, datë 13.4.2015, të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Për kriteret dhe procedurat e emërimit dhe lirimit nga puna të drejtuesve të institucioneve publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional”, bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I, pika IV, “Komisioni i Vlerësimit”, paragrafi 1, germa “b” ndryshohet:
“b. Një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.
2. Në kreun I, pika V, “Konkurrimi”, paragrafi 3 ndryshohet si më poshtë:
“3. Lista shpallet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në portalin elektronik të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe në një vend të dukshëm të institucionit publik për të cilin zhvillohet konkurrimi”.
3. Në kreun I, pika VI, “Përzgjedhja dhe emërimi i kandidatit për drejtues”, paragrafi 1 ndryshohet:
“1. Komisioni i vlerësimit, i paraqet ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe drejtorit të përgjithshëm të SHKP-së raport me shkrim mbi vlerësimin e përmbledhur për kandidatët dhe procesin në përgjithësi”.
4. Në kreun I, pika VII, “Lirimi nga detyra i drejtorit të institucionit të AFP-së”, paragrafi 2 ndryshohet:
“2. Procedura e lirimit nga detyra të drejtorit të institucionit publik ofrues të AFP-së, bëhet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të SHKP-së. Në këtë rast, drejtori i institucionit publik ofrues të AFP-së ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit, para se ky i fundit t’i paraqesë ministrit kërkesën për lirim nga detyra të tij.
5. Në kreun II, paragrafi i parafundit ndryshohet.
Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në MMSR, Drejtoria e Përgjithshme e SHKP-së dhe institucionet publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi